



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:089949
Datë: 26.01.2024
Numri i dokumentit: 05247448

A.nr.1100/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësit M.. Sh., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.. H., avokat nga P..., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për shkak të anulimit të vendimit me numër 03-02/288 të datës 28.02.2022, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 26.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit M.. Sh., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.. H., avokat nga P..., me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi nr. 03-02/288 i datës 28.02.2022 i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së me praninë e palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt. Nga personat tjerë, të pranishëm ishin ekspertët gjyqësor Dr. M.. K.-psikiatër dhe Dr. S.. G., fiziatre.

Paditësi me padinë e datës 05.05.2022, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e tij e ushtruar kundër vendimit të marrë nga e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Shton se vendimi i atakuar është jo i drejtë dhe nuk gjen mbështetje ligjore as në prova materiale dhe se me rastin e vlerësimit nuk është vlerësuar drejtë e drejta materiale duke përsëritur gabimet dhe lëshimet e bëra si në vendimin e parë dhe duke mos respektuar udhëzimet e dhëna nga Gjykata e shkallës së parë. I propozon Gjykatës që të sjell Aktgjykim me të cilin aprovohet padia e paditësit si e bazuar dhe anulohet vendimi i atakuar me padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Kemi pranuar ekspertizën mjekësore ndaj të njëjtës nuk kemi vërejtje sepse rezulton qartë se paditësi i plotëson kushtet që ti njohët e drejta e pensionit invalidor në skemën e invalidit civil t luftës së UÇK-së, dhe atë në mënyrë retroaktive nga momenti i parashtrimit të kërkesës e deri në ekzekutimin vendimit. Gjykatës i propozojmë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare , detyrë e ekspertit do të jetë përllogaritja e vlerës e kompensimit në mënyrë retroaktive të pensionit invalidor nga dita e parashtrimit të kërkesës nga dt.18.07.2019 e deri në pagesën definitive .Nuk kemi pyetje për ekspertët prezent”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Pas administrimit të provave e posaçërisht nga ekspertiza mjekësore vërtetohet themelësia e kërkesëpadisë dhe se paditësit ka zvogëlim të aktivitetit jetësor andaj i propozojmë gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar dhe ti njihet e drejta statusi i invalidit civil të luftës”.*

E paditura, me përgjigjen në padi të datës 22.08.2023 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar duke i propozuar Gjykatës që padinë ta refuzoj si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar i marrë nga e paditura.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vërtetimi me numër 0199/21, dt.08.03.2021, vendimi i dt. 28.02.2022, certifikata e dt. 17.07.2002, ekspertiza mjekësore dftz.20.11.2023, raportet mjekësore të dt.11.06.2015, 02.06.2016, 19.12. ndërsa viti nuk shihet, 26.12.2006, 19.12.2006, 15.04.2014, 09.02.2014, 08.03.2013, 10.09.2018, 19.12.2017, 20.06.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi si dhe propozimin e paditëses për anulimin e Vendimit në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kundërshtuar me padi është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se pretendimet se ekziston vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nuk qëndrojnë.

Për të vlerësuar këtë, gjykata iu referua Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, i cili ka përcaktuar kriteret e përfitimit për secilën skemë pensionale. Në bazë të nenit 3 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1.8 jepet përkufizimi ligjor si në vijim: *“1.8. Invalid civil i luftës - personi, organizmi i të cilit është dëmtuar së paku 40 % si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së fituar në burgjet apo kampet gjatë luftës së fundit në Kosovë, prej datës 27.02.1998 deri me datën 20.06.1999, si dhe personat e tjerë, organizmi i të cilëve është dëmtuar së paku 40 % si pasojë e mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”*.

Me qëllim të vendosjes në mënyrë meritore dhe me jurisdiksion të plotë si dhe me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, me aktvendimin procedural në seancën e shqyrtimit përgatitor të datës 30.10.2023, gjykata aprovoi propozimin e paditësit të bërë me padinë e datës 05.05.2022, duke caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e psikiatrisë, ortopedisë-traumatologjisë si dhe fiziatriisë.

Në bazë të ekspertizës së datës 20.11.2023 të hartuar nga ekspertët gjyqësor, konstatohet shkalla e invaliditetit prej 20%, me çka nuk përmbushet kushti ligjor prej së paku 40%, ashtu siç kërkohet dhe përcaktohet me nenin 3 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1.8 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës. Në lidhje me këtë ekspertizë, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.01.2024, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se nuk ka vërejtje dhe as pyetje për ekspertët e pranishëm.

Në këtë kuptim, gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur të shkallës së dytë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Paditësi nuk dëshmoi pretendimet e tij, ndërsa

faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, e në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1100/2022, datë: 26.01.2024

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.